



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:239306
Datë: 29.04.2022
Numri i dokumentit: 02971908

C.nr. 1599/21

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil me gjyqtaren Afijete Sada Glllogjani dhe sekretaren juridike Vjollca Gaxha, në çështjen juridike të paditëses Sh.H. nga Gj., përfaqësuar nga Fadil Sinanaj avokat nga Gjilani, kundër të paditurit Spitali i Përgjithshëm “Isa Grezda” Gjakovë përfaqësuar nga e autorizuara V.R., kontest pune - kompensim të pagave jubilarë, vlera kontestit 1,721.10euro, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 22 mars 2022, në prezencën e të autorizuarve të ndërgjyqësve, murr këtë:

A K T G J Y K I M

I. P J E S Ë R I S H T aprovohet kërkesëpadia e paditëses Sh.H. nga Gj. dhe D E T Y R O H E T i padituri Spitali i Përgjithshëm “Isa Grezda” në Gjakovë që paditëses të ia paguajë shumën në vlerë prej 1,131.00 euro në emër të shpërblimit jubilar, në vlerë të tri pagave bazë mujore për përvojën e punës mbi 30 vite, me kamatë ligjore 8% nga dita e marrjes së këtij Aktgjykimi e deri në pagesën definitive si dhe të ia kompensojë shpenzimet procedurale në shumë prej 269.00 euro të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

II. Përtej shumës së aprovuar kërkesa e paditëses në shumë prej 590.10 euro u REFUZUA SI E PABAZUAR.

A r s y e t i m

Paditësja me padi dhe gjatë shqyrtimit nëpërmjet të autorizuarit të saj ka parashtruar se është në marrëdhënie pune tek i padituri i sistemuar në punë dhe detyrat e punës infermiere në Repartin e Kirurgjisë të Spitalit “Isa Grezda” Gjakovë, ku aktualisht i ka bërë mbi 30 vite përvojë pune tek i padituri. Paditësja disa herë me kërkesë verbale iu ka drejtuar të paditurit, të ia bëjë pagesën e shpërblimit jubilar, por që deri më tani i padituri nuk i është përgjigjur. Kërkesa e paditëses është parashtruar konform dispozitave të Kontratës Kolektive Sektoriale në nenin 17 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3, në emër të shpërblimit jubilar në vlerë të 3 (tri) pagave mujore $3 \times 573.70 \text{€} = 1,721.10 \text{€}$, pasi që vlerë e një page mujore është 573.70euro. Duke qenë se e paditura nuk ia ka paguar mjetet të cilat ka qenë e obliguar të i paguajë vullnetarisht, paditësës kërkon mbrojtje ligjore për realizimin e të drejtave të saj.

Gjatë shqyrtimit i autorizuari i paditëses në tërësi ka kundërshtuar pretendimet e të autorizuarës së të paditurit sa i përket padisë për të cilën pretendon e njëjta se nuk ka bazë ligjore ashtu që në nenin 2 të Kontratës Kolektive Sektoriale paragrafi 1 decidivisht parasheh se kjo Kontratë gjen zbatim deri në lidhjen e kontratës së re. Ndërsa sa i përket nenit 90 të Ligjit të Punës në rastin e

lidhjes së Kontratës Kolektive Sektoriale Ligji i Punës është vetëm Ligj procedural ndërsa Ligj material është Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve ku dihet mirë se Kontrata mund të vazhdohet edhe në mënyrë të heshtur nëse palët kontraktuese vazhdojnë të sillen njëjtë e që në rastin konkret dihet se I padituri ende punon në bazë të KKS-së të lidhur me datë 11 qershor 2018 p. sh. ku të gjithë punëtorëve ju paguhet kujdestaria në bazë të kësaj kontrate, i paguhet 0.5% e pagës bazë për përvojë në punë, i jepen ditët e pushimit dhe shumë të drejta të tjera andaj nga kjo kuptojmë se ende është në fuqi Kontrata Kolektive Sektoriale. Gjithashtu ka kundërshtuar edhe pretendimet e të autorizuarës së të paditurit sa i përket heqjes së shtesave tjera nga paga mujore gjatë llogaritjes së shpërblimit jubilar për shkak se në KKS- në është paraparë që shpërblimi jubilar të llogaritet me barasvlerën e pagës mujore neto e jo të pagës bazë.

Sa i përket përgjigjes në padi të njëjtën e ka kundërshtuar në tërësi si të pabazuar në legjislacionin në fuqi.

Në fjalën përfundimtare i autorizuari i paditëses ka deklaruar se : pas administrimit të provave ka konsideruar se është vërtetuar themelësia e kërkesëpadsisë ashtu që nga kontrata e punës vërtetohet fakti se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura në kohë të pacaktuar, nga vërtetimi i lëshuar me datë 22 shtator 2021 e njëjta i ka bërë 30 vite të përvojës së punës, nga lista e pagës e muajit gusht vërtetohet se paditësja pagën mujore neto e ka në shumë 573.70 euro kur të e shumëzohet me 3 jep vlerën 1,721.10 euro, gjithashtu në listën e pagës tek kolona MAP në muajin prill të çdo viti kalendarik bënë ndryshimin e këtyre viteve të përvojës në punë që nënkupton se paditësja ka 30 vite të përvojës në punë, i ka bërë para datës 11 qershor 2021, që nënkupton se para se të bëj tri vjet të përdorimit KKS-së. Andaj kërkojë nga Gjykata që në tërësi të aprovojë kërkesëpadsinë e paditëses si të bazuar dhe të e detyrojë të paditurin, që paditëses të ia paguajë shpërblimin jubilar në vlerë të tri pagave mujore të saj, për shkak se e njëjta ka 30 vite të përvojës në punë.

Shpenzimet procedurale i ka kërkuar për taksë gjyqësore shumë 30.00euro, për përpilim të padsisë shumë 104.00 euro, përfaqësim në seancë shumë 135.00, gjithsejtë 269.00 euro.

I padituri me përgjigje në padi ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e paditëses, pasi që me Ligjin e Punës nuk është paraparë kompensimi i shpërblimeve jubilarë. Sipas nenit 90 pika 5 të Ligjit të Punës thuhet se zbatimi i një Marrëveshje Kolektive vlen vetëm për ata punëdhënës dhe punonjës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen kolektive, e që në rastin konkret nënkupton se i padituri nuk është nënshkruer i marrëveshjes në të cilën bazohet padia dhe rrjedhimisht nuk bart përgjegjësi të tillë ndaj palës paditëse, prandaj pasi që marrëveshja është lidh midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë të Kosovës, paditësja është dashur që të e obligoj Ministrinë e Shëndetësisë për përmbushjen e një obligimi të tillë, pasi që ajo është nënshkruese e marrëveshjes. Duhet theksuar po ashtu se nga Qeveria e Kosovës përkatësisht Ministria e Financave nuk është paraparë vija buxhetore për këtë kategori prandaj në mungesë të linjës buxhetore përkatësisht të mjeteve financiare nuk ka mundësi objektive, për ta përmbush obligimin e kompensimit të pagave jubilarë për faktin se veprimi në drejtim të kompensimit të pagave jubilarë është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit mbi Ndarjen Buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021. Lidhur me shpërblimin jubilar për 20 vite pune të paditëses, i padituri me datë 24 qershor 2021 ka pranuar Aktvendimi e Gjykatës Themelore në Gjakovë PPP,nr.425/20 të datës 09 qershor 2021.

E autorizuar e të paditurit ka kundërshtuar në tërësi padsinë dhe kërkesëpadsinë e paditëses pasi që paditësja ka bërë padsinë në këtë Gjykatë me datë 16 dhjetor 2021 ndërsa KKS ka hyrë në fuqi më datë 11 qershor 2018 ka konsideruar se padia për pagesën e shpërblimit jubilar është

parashtruar pas afatit kohor prej tri vitesh prej nënshkrimit të Kontratës Kolektive Sektoriale, Në bazë të Ligjit 03/L-212 të Punës dialogu social neni 90 paragrafi 4 thuhet se : Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se 3(tri)vjet. Padiësja ka ushtruar padi për pagesën e shpërblimeve jubilarë pas afatit kohor prej tri vitesh prej nënshkrimit të Kontratës Kolektive Sektoriale të datës 11 qershor 2018 , andaj konsiderohet e pas afatshme.

E autorizuar e të paditurit gjatë shqyrtimit dhe në fjalën përfundimtare ka mbet pranë parashtrimeve si në përgjigje të padisë. Po ashtu ka kundërshtuar pretendimet e padiësës pasi që i njëjta nuk ka paraqitur kërkesë me shkrin në institucionin për pagesën e shpërblimit jubilar gjegjësisht nuk i ka shtjerrë mundësitë e shfrytëzimit të mjeteve të brendshme juridike. Ka kundërshtuar edhe shtesën e paraqitur në listën e pagës-shujtën, kujdestarinë dhe shtesën emergjente për Covid 19 pasi që shtesat mbi pagë nuk mund të jenë objekt i përfitimit për padiësën pasi që Ligji i punës ka bërë dallimin në mes të pagës dhe shtesave tjera të punës. Ka propozuar që padia dhe kërkesa e saj të refuzohet si e pa bazuar.

Shpenzime procedurale nuk kërkojë.

Për të vendosur në këtë çështje juridike Gjykata bëri nxjerrjen e provave si : Kontrata e Punës datë 31 dhjetor 2012 në kohë të pacaktuar, Vërtetim i marrëdhënies së punës datë 22 shtator 2021, Lista e pagave për muajin gusht 2021, letërnjoftimi me numër të ID... MPB Kosovë, ku pas vlerësimit veç e veç të këtyre provave dhe në lidhshmërinë tyre reciproke gjeti se kërkesëpadia e padiësës është pjesërisht e bazuar dhe si tillë u aprovua.

Nga Kontrata e punës nr. prot 3159 datë 31 dhjetor 2012 vërtetohet se padiësja është në marrëdhënie pune tek i padituri Spitali Rajonal “Isa Grezda” në Gjakovë në punë dhe detyrat e punës Infermiere e Përgjithshme nga data 01 janar 2013 në kohë të pacaktuar. Nga vërtetimi i të paditurit datë 22 shtator 2021 provohet se padiësja është e punësuar tek i padituri Infermiere në Repartin e Kirurgjisë prej datës 01 qershor 1991 e tutje dhe sipas dosjes së personelit ka 30 vite përvojë pune. Nga Lista e pagave e muajit gusht 2021 vërtetohet se padiësja ka realizuar pagën neto në shumë 633.70 euro, ka 30 vite përvojë pune është anëtare e Sindikatës dhe paguan anëtarësi. Me pagën neto padiësja ka realizuar shtesa në emër të shujtës shumën 45.76 euro, në emër të Covid 19 shumën 60.00 euro dhe në emër të kujdestarisë shumën 189.01 euro. Paga bazë e padiësës është në shumë prej 377.00 euro.

Në bazë të Kontratës Kolektive Sektoriale për Shëndetësi, neni 17 paragrafi 3 pika 3.3 dhe paragrafët 4 është paraparë se: “Punëtorët shëndetësor, në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblim jubilar nga punëdhënësi i fundit, për 30 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, në vlerë të tri paga mujore të tij “. Paragrafi 4 i të njëjtit nen përcakton se “ Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë . Shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf”.

Neni 2 i KKS-së rregullon kohëzgjatjen e Kontratës e cila ka hyrë në fuqi më datë 11 qershor 2018, sipas paragrafit 1 i Kontratës afati i zbatimit të kësaj Kontrate është në kohëzgjatje prej 3 (tre) vjet nga dita e lidhjes së saj, respektivisht nga momenti i nënshkrimit nga palët në këtë kontratë, dhe gjen zbatim deri në lidhjen e kontratës së re, ndërkaq paragrafi 2 “ Me kalimin e afatit sipas paragrafit 1 të këtij neni, palët mund të vazhdojnë KKS-në për afat të ri apo të lidhin kontratë të re”. Neni 4 i kësaj Kontrate rregullon fushën e zbatimit të saj, paragrafi 1 i këtij neni thekson se “KKS-ja gjen zbatim në rregullimin e raporteve juridike për të gjithë të punësuarit nëpër institucione shëndetësore duke përfshijë tri nivelet e sistemit shëndetësor, atë parësor

dytësor dhe tretësor. Paragrafi 2 fushë zbatimi i KKS-së ushtron efekt tek punëtorët shëndetësor dhe administrativ në institucionet shëndetësore.

Paditësja i ka përmbush të gjitha kushtet dhe kriteret për marrjen e tri pagave jubilarë, pasi që ka përvojë pune të pandërprerë për mbi 30 vite tek i padituri si punëdhënës i fundit dhe aprovoj pagën bazë mujore në shumë prej nga 377.00euro, për tre muaj gjithsejtë shumën në lartësi prej 1,131.00 euro, ndërsa refuzoj shumën në lartësi prej 590.10euro si të pabazuar, shumë e kërkuar si paga neto mujore 633.70 euro nga e cila pala paditëse kishte hequr shtesën për Covid 19 në shumë 60.00 euro dhe ka kërkuar paga në lartësi 573.70 euro.

Në bazë të nenit 55 paragrafi 2 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 "Të drejtën në pagë, pagën shtesë, kompensim në pagë dhe të ardhurat tjera, i punësuari i realizon sipas marrëveshjes së arritur me punëdhënësin për punën e kryer dhe kohën e kaluar në punë, të përcaktuar me kushtet e punës dhe duke u bazuar në nenin 8 të Kontratës së punës ku " Të punësuarit i caktohet paga bazë për punën të cilën e kryen për punëdhënësin..." Pasi që shumica e refuzuar nuk kishte mbështetje ligjore u vendos si në pikën II-të të dispozitivit të Aktgjykimit.

Gjykata, me rastin e vendosjes murr parasysht edhe nenin 90 paragrafi 5 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, me të cilin parashihet se: Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive. Sipas neneve të lartë cituara është paraparë detyrimi i punëdhënësit në rastin konkret i të paditurit për kompensimin e shpërblimit të kërkuar, e njëjta e nënshkruar nga Ministria e Shëndetësisë dhe FSSHK prodhon efekt juridik ndaj punëdhënësit të cilët kanë të punësuar punëtorët që të drejtat e tyre burojnë nga ajo kontratë, në rastin konkret i padituri është punëdhënës i paditëses dhe detyrohet për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga ato kontrata.

Bazuar në nenin 382 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve parashihet se " debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën e që lartësia e kamatë vonesës është 8% në vit, për veç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë". Paditëses i takon kamata e kërkuar nga data 22 mars 2022 për shkak të rënies në vonesë të paditurit për përmbushjen e detyrimit të tij sa i përket pagave jubilarë të kërkuara.

Me rastin e vendosjes Gjykata murr parasysht pretendimet e palës së paditur paraqitur në përgjigje në padi dhe gjatë shqyrtimit u konsideruan pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u murr bazuar në nenin 452 paragrafi 1 të LPK-së dhe TA ku paditëses i ka njohur të drejtën e shpenzimeve procedurale për taksë gjyqësore shumën 30.00 €, për përpilim të padisë shumën 104.00€, përfaqësim në seancë shumica 135.20€, gjithsejtë shumën 269.20€.

Nga sa u cek më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË
C.nr. 1599/21, datë 22 mars 2022

Gj y q t a r j a,
Afijete Sada Glligjani

UDHËZIM JURIDIK; Kundër këtij Aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, pas marrjes së tij Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë nëpërmjet kësaj Gjykate.